



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL

### NGA SEANCA E DYTË E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Seancën e ftoi dhe e kryesoi kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë, z.Naim Pira. Seanca është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, në Shtëpinë e Kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani” në Viti, më 24.02.2016 (e Mërkurë), duke filluar nga ora 10.<sup>00</sup>.

Në seancë prezantuan 26 anëtarë të Kuvendit, mungoi një këshilltarë me arsye. Në seancë ishin prezent edhe nënkryetari i Komunës z.Hasan Alia me drejtorët e Drejtorive, përgjegjësja e Zyrës Ligjore, përfaqësuesi i OSBE-së, OJQ-të dhe mediat e shkruara dhe elektronike.

Kryesuesi para se të filloj me punë sipas rendit të ditës i përshëndeti të gjithë të pranishmit, si: nënkryetarin e Komunës, këshilltarët e Kuvendit, drejtorët e Drejtorive, përfaqësuesin e OSBE-së, OJQ-të, mediat etj. Pas numërimit nga sekretaria të këshilltarëve në sallë, kryesuesi konstatoi se kemi kuorum dhe mundemi me filluar me punë të seancës së II të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë.

**Kryesuesi:** Para se të kalojmë në miratimin e rendit të ditës: A ka dikush ndonjë pyetje për seancën e dytë të kuvendit?

**z.Sejdi Emini:** Unë sot para se të vija këtu, në shkollë e mora një informatë, që më erdhi shumë interesante, kryetari i sindikatës së shkollës tha, që për 7 Mars po përgatitet një ndejë për arsimtarë, domethënë për nder të festës së 7 Marsit - Ditës së Mësuesit. Mirëpo, ajo që më shqetësoi më së shumti është, që komuna po ua hjek gjysmën e shpenzimeve punëtorëve të arsimit, nuk di çfarë arsye ka komuna me ua hjek punëtorëve të arsimit darkën ose drekën, kur punëtorët e arsimit pothuajse gjithë minimumi e kanë pagën 450 euro. Unë mendoj që ka shumë, shumë probleme ma të mëdha në arsim, Ministria e Arsimit ka probleme prej ma të voglave që i kemi përmendur shumë herë e tash me i shpenzuar dikund 3000 euro për dreka e darka, unë nuk po e shoh të arsyeshme. Nëse e keni marrur këtë vendim tërhiquni se keni ku i qoni parat për gjëra më të vogla e të nevojshme. Nuk po më pëlqen, prapë po kërkoj me u tërhiq prej këtij vendimi, se ndoshta mendoni me bërë edhe politikë, por politikë me bërë është herët pak dhe s’po e shoh të arsyeshme, sepse ka me gjendje sociale, asistencë sociale, me dhjetëra e dhjetëra pa kulm mbi kokë, edhe në arsim ke probleme ma të voglave drejtor. Kisha kërkuar që mos të bëni këtë gabim, që punëtorët e arsimit, që askush nuk e din së paku 450 euro e kanë mëditjen. Po donë me shkuar me bërë një qef, le të shkojnë me para të veta, edhe unë jam punëtor i arsimit, por nuk po më pëlqen.

**znj.Mirlinda Sadiku:** Pasi që jam pjesë e rrjetit të grave, të gjithë jeni në dijeni në lidhje me një shkrim në facebook, të cilin e ka bërë kryeministri. Faleminderit shumë kryeministër për këtë dhuratë për 8 Mars, le të jetë në ndërgjegjen tënde prej akademiku.

Çështjen tjetër që do ta kisha ngritur, është një propozim që të parashihet këtë vit, të bëhet një investim në rrugën "15 Prilli" në fshatin Skifteraj dhe rrugën "Rrust Sadiku". Aty veç e ka evidentuar gjendjen, sipas disa informatave që i kam nga fshatarët që më kanë treguar, ka qenë edhe kryetari i komunës dhe janë në gjendje të keqe të dy rrugët. Sipas asaj që i kam pyetur qytetarët e kam vërejtur një gjë, këta qytetarë i përgjigjen tatimit në pronë më shumë se 60%, prandaj e meritojnë që ti kthehet si investim kapital.

**z.Bekim Azizi:** E kisha filluar sot me një vërejtje kryesues për juve, në seancën solemne të 17 Shkurtit dhe në seanca tjera është duke na përcjellur, që seanca solemne mbahet me këshilltarët komunal, ndërsa këshilltarët komunal vetëm 6 kanë qenë që kanë pasur vend me u ulur, ndërsa tjerët nuk kemi pasur vend ku me u ulur as ku me ndejt. Unë mendoj që seancat tjera që janë solemne, pasi që është seancë e kuvendit, këshilltarët duhet ta kenë vendin e vet të caktuar, pastaj të gjithë të pranishmit janë të mirëseardhur, sepse edhe qytetarët janë të mirëseardhur, mirëpo seanca mbahet me këshilltarë dhe ne duhet ti kemi vendet, përndryshe seancat tjera nuk do të përgjigjemi nëse i kemi kushtet si me 17 Shkurt.

Do të isha lidhur shumë pak te një informatë që më është sjellur për kanalizimin e Smirës, sepse e kemi diskutuar goxho shumë. Në bazë të kësaj informate që më ka ardhur e pash që shumicën e vërejtjeve që i kemi dhënë janë këto, është mirë që nuk është pranuar, përmendet që trotuari është i dëmtuar, një pjesë e mirë nuk është kryer, prerja e asfaltit në disa vende që është bërë nuk është kryer, gropa septike nuk është kryer, shaktat nuk janë disa funksionale dhe diku rreth 360 metra rrjet nuk është kryer. Mendoj që duhet të jenë të kujdesshëm të kryhen, mirëpo raportit nuk i është bashkangjitur një dokument, që e kam kërkuar për mjetet e zotuarra të kanalizimit së Smirës dhe Tërpezës, që i kanë bartur në projekte të tjera. Atë dokument prapë e kërkoj dhe kërkoj dokumentin e ndihmave momentale nga subvencionet e Zyrës së Kryetarit për vitin 2014, po e përsëris që në seancën tjetër të sjellet.

**z.Zekirja Zuka:** Kam dy pyetje për seancën e sotme. E para ka të bëj me inspektionin komunal e sidomos për atë sanitar, fjala është për burimi apo kroin në Lubishtë. Ju e dini se aty mbushin ujë shumë qytetarë, jo vetëm nga Vitia, por e gjithë Kosova, por ajo çka më shqetëson mua dhe qytetarët është se çfarë përbërje ka ky ujë. Unë dua të pyes inspektionin komunal: Se a janë bërë analizat adekuate këtij uji, nëse janë bërë, pse nuk është vendosur një pllakë apo tabelë informimi rreth përbërjes së këtij uji dhe të informohen njerëzit se a është ky ujë i pijshëm apo jo? Unë propozoj që menjëherë të merren masa adekuate dhe të bëhen analizat në institutin kombëtar të higjienës së Kosovës dhe ata të na informojnë rreth përbërjes së këtij uji nëse është i pijshëm apo jo. Ndërsa pyetja e dytë ka të bëj me kryetarin, ka të bëjë më shumë rreth objektit të komunës së re. Unë dua ta di se a do të kemi kënaqësinë ne, kjo përbërje e këtij Kuvendi, të ulemi në atë sallë që është e paraparë për kuvendarë apo do të vazhdojmë edhe këto dy vite të ardhshme ta marrim reumën në këtë sallë. Kërkoj nga kryetari që sado pak të na jap një datë përafërsisht mbi përfundimin e këtyre punimeve.

**z.Hasan Aliu:** Më lejoni që të bëj përpjekje që të përgjigjem në pyetjet që i bën këshilltarët. Këshilltari pyeti për sindikatën që paska bërë një organizim, mua po më vjen mirë që kanë organizuar, po më vjen mirë që edhe kryetari i komunës iu ka paguar 50%, megjithatë ne po jetojmë në vitin 2016, pavarësisht, unë nuk të them pajtohu me mua, por duhet të kemi në konsideratë shumë prej punëtorëve arsimor që kanë punuar me 9 vite pa pagë, kanë rrezikuar, i kanë edukuar brezat, prandaj unë konsideroj që shoqëria iu ka borxh shumë ma shumë se ato, ajo është simbolike dhe ajo nuk është politike, por është respekt. Mirlinda që i shtroj dy

çështje, unë konsideroj që do të jetë, cila rrugë do të shtrohet nuk e di, por besoj të gjitha ato që i shtroj këshilltarja është shumë me vend, dhe Bekimi që e tha, ne edhe pas mbajtjes seancës e kemi mbajtur një takim, ai shqetësim e ka prekur edhe kryetarin edhe mua edhe të tjerët, mirëpo më tepër është e varur nga niveli i kulturës së pjesëmarrësve, se me të vërtetë këshilltarët e Kuvendit Komunal duhet ta kenë vendin e vet, duhet ta kenë emrin dhe mbiemrin, por duke menduar se do dalim në komunën e re, secili drejtor dhe këshilltar do ta kenë vendin e vet. Sa i përket ujit, nuk është investuar për të nga komuna që ta ketë atë pllakatë, dhe çështja e komunës së re, e kam pasur një takim dhe më dhanë informacion se ata kanë dalur ta kenë një regjistrim të gjendjes edhe të punëve që janë kryer dhe do ta bëjnë shkëputjen e kontratës me ata që e kanë pasur deri tash dhe një barazim të gjendjes që janë kryer dhe mjetet të cilat i kanë marrur dhe është thënë brenda këtij viti që komuna ka me qenë e kryer, por sa je ti optimist aq jam dhe unë, por nuk varet nga na.

**z. Qahil Sinani.** Pyetja që u shtrua rreth 7 marsit, është e vërtetë që kemi një bashkëpunim me sindikatën e arsimit që tua paguajmë atë drekë 50 me 50, 7 marsi është ditë e shenjtë ngase në 7 mars pikërisht në komunën e Vitisë kemi dy shkollat e para shqipe, në Stubëll dhe Pozheran, ende nuk është definitive.

**z. Sejdi Emiri:** Po e marr fjalën ore burrë se për këtë punë jemi këtu, nuk jemi ardhur për diçka tjetër, nëse nuk flasim po i mbledhim letrat dhe po ecim, për këtë jemi, ashtu kështu një herë në muaj po vijmë le të ka debat, le ta dinë edhe qytetarët për çka jemi ardhur, për çka jemi votuar.

Nënkryetar, mos mendo se i respekton punëtorët e arsimit më shumë se dikush tjetër, është fakt që meritojnë respekt, por unë po e përsëris prapë, po nisem prej vetes se ndoshta ndonjëherë po dal edhe i tepërt, me ardhur në shkollën ku punoj, ka qenë drejtori i Financave, ka qenë drejtori i Arsimit, nuk ka fletë as A4, nuk ka as fotokopje për test, nuk ka as banjo funksionale, që punëtorët aty detyrohen në shtëpi të shkojnë kur kanë nevojat e veta, prandaj ti tu qitësh dreka e darka, s'po e shoh të arsyeshme. Pse? E kemi pagën 450 euro, apo donë të me nderosh, jepma një laps për nder të 7 Marsit edhe kryhet puna ose një mirënjohje, një letër, por para nuk keni ju me dhënë për darka e dreka, jam shumë i sigurt që kemi nevoja shumë, shumë të mëdha.

**z. Hasan Aliu:** Në qoftë se po donë me i fryer negativisht, ke marrur laps për çdo vit dhe pse nuk po bëhesh pak korrekt, ajo nuk ka qenë iniciativë e komunës, një çështje duhet ta dallosh, ajo ka qenë iniciativë e arsimtarëve që bijnë në sindikatë dhe e kanë shtruar si kërkesë, mos shiko të bëhesh shume atdhedashës, edhe në kohërat e luftës organizohet një çështje e tillë, unë po ta përsëris, ai brez i arsimtarëve meriton shumë ma shumë se kjo dhe kjo është simbolikë të cilën ia ka miratuar kryetari. Mund të ndodh po të isha në vend të kryetarit do ua paguaja të gjithën. Ti ke të drejtë ta ndash mendimin, ke edhe letër edhe fotokopje, unë e di që ti ndoshta ke nevojë edhe me të qu me të edukuar, por shkollë të tillë nuk kam. Një çështje kur ti nuk je në gjendje me dëgjuar një njeri në sqarim, duhet t'ia bësh pyetje vetvetes çfarë terapie të duhet, dhe çështja tjetër që po të them me sinqeritetin me të madh, ti e more përgjigjen tash a të konvenon apo jo është çështje tjetër, për këtë arsye ne jemi të ndarë, ti je me një subjekt, unë me një subjekt tjetër, ti ke të drejtë me ndarë mendimin, por me e imponuar mendimin jo.

**z. Bislim Bislimaj:** Edhe unë isha kyqur me gjithë qef, por çështja është këtu që jemi një pjesë e mentalitetit të kaluar e ndoshta edhe unë i takoj atij mentaliteti, nëse nuk dëgjohet fjala dhe arsyetimi i atyre që kanë nevojë nuk e shoh të arsyeshme që të reagojmë e të themi se ke nevojë për terapi, ne të gjithë kemi nevojë për terapi sepse në gjendje të tillë jemi pas luftës. Ne po thojmë dhe gjithmonë kemi thënë, që kemi nevoja të mëdha si në arsim, si në

shëndetësi e në çdo lëmi. Nuk kemi ndarë kurrfarë fondi, kurrfarë ndihme e subvencioni në asnjë lëmi e në anën tjetër projektet e kuvendit të mëhershëm që ka qenë e edhe këtij po na mbesin në gjysmë. Ata që kanë qenë më meritoret për këtë liri nuk po respektohen, pa tregoni që i keni dhënë dikujt ndonjë dekoratë ndonjë familje dëshmori ose ndonjë invalidi, a keni dhënë ndonjë shtëpi, ndonjë banesë apo keni dhënë diçka që mundeni me thënë faleminderit që bëtë diçka për këtë vend. A thatë që mësuesit e kanë merituar dhe e meritojnë, por nuk kemi sepse s'ke ma së pari kushte higjienike nëpër shkolla, nxënësit tanë janë duke vuajtur për kushte higjienike, ejani në shkollën e Drobeshit dhe e shihni se çfarë kundërmimi vjen. Ejani nëpër shkollat tjera dhe shikoni sa mjete po ndahen për mjete higjienike. Në kohën e kompjuterëve nxënësit tonë nuk e kanë parë ende qelizën me sy, a shtetet tjera punojnë me milionat e milimetrit. Sindikatat ju e dini si janë duke punuar, por ju jeni duke marrë para nga ta që 5-6 vjet shpërndajeni, por mos bëni darkë, por bëjeni koktej me ato parat e sindikatës, asnjë sindikatë nuk i ka ndihmuar ndonjë arsimtari në nevojë, pra të gjithë janë të kapur, të gjithë janë duke zhvatur, na kanë mbetur projektet në gjysmë, kjo ku jemi ne vetëm prej pas luftës dy herë është djegur, është ndërtuar, është rinovuar, është djegur prapë dhe ku e pash një shifër 35 mijë euro janë ndarë për ta rinovuar, ku po i qoni ato para, kur nuk kanë populli, nuk kemi ne, kemi projekte shumë ma madhore ne të rinovojmë, të prishim, të djegim, të shkatërrojmë dhe të mos jep askush përgjegjësi, këtë është duke thënë Sejda, unë po mbahem me të rinjtë, ju mbahuni qysh tua merr mendja.

**z.Sejdi Emini:** Ndoshta kanë kërkuar terapi me më gjet, por për mua nuk kanë këta terapi, është fakt që jam sëmundje se 4-5 vite për ta, por nuk kanë me mundur me gjet me më shëruar, është sëmundje që në të gjitha format kanë menduar me më thyer dhe me më shkelur, por nuk kanë mundur, unë jam vetvetja dhe do të mbetem vetvetja, nënkryetar.

Tjetra, me marr me i shikuar gjërat hollë e hollë, unë jam i zgjedhur i qytetarëve nuk je ti, ti je i deleguar, nëse unë nuk kam të drejtë të flas me qytetarët ti edhe më pak, unë po them që ato para janë tonat, prapë po e përsëris dhe nuk është e ndershme me keqpërdor me darka dhe dreka. Është mbyllur shkolla jonë në Goshicë, keni thënë që ka qenë politike, në prag të mbylljes është prapë, po të paralajmëroj në prag të mbylljes e ke, e ti qit dreka e darka.

**z.Skender Ahmeti:** Ishte një pyetje nga deputeti Zeka për çështjen e ujit të pijes, që ka investuar një person, Muhamet Ademi në Lubishtë. Komuna e ka një kontratë me institutin e shëndetit publik, i cili bën analizat e ujit në të gjitha vendburimet që ka Komuna e Vitisë, prandaj në mesin e tyre inspekcioni sanitar së bashku me institutin e shëndetit publik ka bërë analizën e ujit në atë vend dhe ai ujë i plotëson kushtet në aspektin higjieniko-sanitar, është shumë i mirë dhe përveç institutit të shëndetit publik edhe personi privat i ka bërë analizën edhe në Prishtinë me kosto diku 350 euro, prapë analizat kanë dal se uji është shumë i mirë, po ta kisha pasur një kërkesë të tillë më herët do tua kisha sjellur, por në seancën e radhës mundem t'ua bij edhe rezultatin e analizave. Për çështjes e asaj pllakatës me e vendosur mundemi me ndërtuar edhe atë për shkak që qytetarët e lexojnë, por për fat të mirë është uji shumë i mirë.

**Kryesuesi:** Ju falënderoj për kontributin që dhatë rreth pyetjeve dhe propozimeve, për seancën e dytë të rregullt të Kuvendit të Vitisë kemi paraparë këtë:

#### **REND DITE**

- 1. Shqyrtimi i procesverbalit nga seanca e parë e kuvendit komunal të Vitisë.**
- 2. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar-dhjetor 2015.**
- 3. Propozim për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për LMK.**

4. **Propozim vendim për shpalljen zonë me interes të përgjithshëm parcelat në zonat kadastrale në Viti dhe Sodovinë të Jerlive, të cilat prona janë të menaxhuara nga AKP-ja.**
5. **Informatë mbi procesin e legalizimit të objekteve.**
6. **Informatë mbi përgatitjen dhe mirëmbajtjen e rrugëve në sezonin dimëror.**

**Kryesuesi:** A ka dikush rreth rendit të ditës diçka? Nëse jo, atëherë kalojmë në votim: Kush është që të miratohet ky rend i ditës me këto pika? Atëherë me vota unanime miratohet rendi i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi

#### **1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e Kuvendit të Komunës së Vitisë.**

**Kryesuesi:** Hapim debatin lidhur me procesverbalin nga seanca e parë e Kuvendit të Komunës së Vitisë: A ka dikush ndonjë vërejtje në procesverbal?

**z.Besjana Rexhepi:** Pata një vërejtje në hartimin e këtij procesverbali, por para saj kam dy komente rreth çështjeve që u diskutuan më parë nga Vetëvendosja. Lidhur me çështjen e dhënies së mirënjohjeve, është e vërtetë se komuna ka nda një shumë nga buxheti për këtë lloj darke, mirëpo duhet ta keni parasysh se dhënia e mirënjohjeve është shumë me vend se arsimi është shtylla kyçe për shtetin. Tjetra, çështja e printerëve, është shumë e vërtetë se janë të nevojshëm në shumicën e shkollave, po mos të harrojmë se edhe po keqpërdoren prej mësimeve, po përdorën për nevoja personale. Për çështjen e higjienës, është e vërtetë se gati në çdo shkollë kundërmon era si pasojë e jo higjienës në nivel, por mendoj se jo higjiena nuk është faj i komunës, por i personave kompetent që nuk e kryejnë detyrën ashtu siç duhet. Kërkoj që inspeksioni të bëjë mbikëqyrjen e higjienës nëpër shkolla.

Sa i përket vërejtjes në procesverbal, e di që personi që merret me lektorim gjuhësor shkruan në procesverbal ashtu siç e flet ansambleisti, mirëpo ta kemi parasysh që janë disa fjalë të cilat thuhën dhe ndryshe shkruhen. Shembull konkret e kemi koeficientin e intelegjencës që shkruhet me IQ e jo ajkjusë, siç e ka shkruar ky personi që merret me lektorim gjuhësor.

**Bekim Azizi:** Në faqe 13 të procesverbalit është shënuar fjala ormiset e punësimit, kurse duhet të jetë premisat e punësimit, ngase edhe ashtu kjo fjalë qenka e nënvizuar për tu sqaruar.

**Kryesuesi:** A dëshiron edhe dikush fjalë lidhur me procesverbalin, nëse jo atëherë me vërejtjet që u dhanë: Kush është që procesverbalin të miratohet? Me votim unanim Kuvendi miratoi procesverbalin nga mbledhja e parë e Kuvendit me dy vërejtjet e paraqitura.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi

#### **2. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar-dhjetor 2015**

**Kryesuesi:** Ftoj drejtorin e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim që ta paraqet një fjalë hyrëse lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Ibrahim Rama:** Si zakonisht pasqyrat financiare me ligj janë të obliguara çdo 3 muaj ti paraqesin para organeve gjegjëse, duke filluar nga bordi i drejtorëve, në KPF dhe në kuvendin e mbledhjes vijuese dhe gjithnjë pasqyrat financiare tregojnë shpenzimet e buxhetit të miratuar nga këshilltarët komunal në vitin paraprak. Këto gjithnjë përpilohen në bazë të ligjit për vetëqeverisje lokale, ligjit për financat lokale dhe ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Pra në bazë të këtyre ligjeve ne jemi të obliguar ti paraqesim pasqyrat për

shpenzimin e buxhetit për vitin 2015. Materialin e keni pranuar me kohë, për pyetje, përgjigje jam në dispozicionin tuaj.

**Kryesuesi:** Hapim diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

**Vjollca Kadolli Halili:** Sot po i shqyrtojmë Pasqyrat Financiare për periudhën janar – dhjetor 2015. E falënderojmë drejtorinë për prezantimin që e ka bërë dhe që me kohë po i përgatit pasqyrat financiare. Këtu kemi të paraqitur në mënyrë analitike pasqyrën e të hyrave, shpenzimeve dhe investimeve kapitale të cilat janë krye në këtë periudhë. Sa i përket shpenzimeve, vërehet se është një rritje prej 531.000€, mirëpo kur shikohet në pasqyrë analitike del se 575000€ janë shpenzime të rritura për paga dhe mëditje. Kështu kur e bëjmë në tërësi analizën del se për 44.000€ shpenzimet janë më të ulura për vitin e kaluar. Te të hyrat vetanake del se të hyrat janë më të ulura për 94.000€. Këtë e paraqiti edhe drejtori në fjalën hyrëse. Planifikimi i të hyrave komunale është bërë në bazë të caktimit të limitit nga Qeveria e Kosovës, ku është caktuar shuma që Komuna e Vitisë duhet të inkasoj të hyra vetanake në shumë prej 1.008.000€. U tha se në inkasimin e ulet të tatimit në pronë ka ndikuar Vendimi i Qeverisë për faljen e borxheve. I mbetet drejtorisë që të gjejë një formë dhe të bëjë inkasimin e të hyrave komunale nga tatimi në pronë, pasi kjo është bazë e të hyrave komunale. Sa i përket investimeve kapitale është përshëndetur një punë e mirë që është bërë në teren në të gjitha sektorët, në të gjitha lokalitetet dhe lirisht mund të thuhet se Vitia ka ndryshuar për të mirë. Shihet se kemi realizim të buxhetit 98.9%. Nuk na mbetet tjetër vetëm ta inkurajojmë qeverinë komunale që të vazhdoj ti realizoj objektivat të cilat i kanë paraparë.

**Samet Idrizi:** E përcjella me vëmendje diskutimin e Vjollcës, shefe e grupit të LDK-së, mendoj se vet Vjollca u dashtë me kritikuar punën njëvjeçare të qeverisë komunale, se ka pas arsye shumë të madhe. Investimet kapitale, donacionet nga palët e treta dhe të hyrat vetanake të inkasuara gjatë vitit 2015 krahasuar me vitin 2014, këta tre indikator janë të konsiderueshëm më të ulët se në vitin 2014. Çka rrjedh nga kjo, se kemi pas një qeveri regresive. Këtu nuk flitet për progres absolutisht, duke filluar nga kryetari, drejtori i Financave dhe drejtorëve të tjerë, që janë pjesë përbërëse e këtij raporti, në fund drejtori i financave e bënë një përmbledhje të punës një vjeçare. Inkasimi i të hyrave vetanake të realizuara në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014 është më i ulët për 18.48%. Pastaj kemi rritje të shpenzimeve aty ku qeveria aktuale lokale është zotuar se do të bëjë shkurtime, duke filluar prej shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit kemi rritje, pastaj po ashtu unë kam vërejtje se gjatë raportimeve periodike që i ka bërë drejtori i Financave për disa shpenzime si p.sh.: të rrymës, vazhdimisht duke i krahasuar kanë dalë më të vogël, por tash kur janë përmbledh në pasqyrë del se janë më të mëdha, p.sh.: kur i ka raportuar shpenzimet e rrymës në tremujorsha, kanë dal sigurisht më të vogla, kurse tash dalin në vitin 2015 shuma prej 138.614€, kurse në vitin 2014 kemi pasur 106.786€. Këtu del se kemi rritje të shpenzimeve të rrymës dhe është normale se kemi pasur shtrenjtim të rrymës elektrike. Shërbime kontraktuese tjera, shërbime teknike, shpenzime tjera profesionale intelektuale duhet me u raportuar më drejt se ku janë shpenzuar këto mjete, duhet me u dhënë në fund me një vërejtje se ku janë shpenzuar këto mjete, por nuk është bërë. Faqe 4 shihet se kemi ngritje të shpenzimeve për ngrohje qendrore, furnizimi me lëndë djegëse edhe këtu kemi ngritje për 25%, drunjat janë paguar më shtrenjtë, 83,200€ kanë qenë në vitin 2014, kurse 109.732€ janë në vitin 2015. Te mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, përkundër se janë blerë disa vetura të reja prapa kemi rritje diku në masë prej 25%. Në vitin 2014 janë shpenzuar gati 19,000€, kurse në vitin 2015 janë shpenzuar 24.291€ edhe kjo është një rritje prej 25% krahasuar me vitin 2014. Investimet kapitale janë më pak për 12%, kjo është me u shqetësuar jo vetëm për investimet

kapitale, por edhe për të hyrat vetanake, donacionet etj. Të hyrat komunale janë më të vogla se në vitin 2014 diku për 94.000€, nga kjo del se ka nevojë për shtim të disiplinës në punë të gjithëve, duke filluar prej portirit deri te drejtorët përkatës dhe vet kryetari me qenë kontrollues më i fortë në këtë drejtim. Duhet të punohet, sepse me pasur një rënie prej 18% në vitin 2015 krahasim me 2014 në inkasim vetanak menjëherë në vitin e dytë të qeverisjes duhet të brengoset edhe opozita, por më shumë pozita, sepse i ka frerët në dorë për të qeverisur Komunën e Vitisë. Faqe 22, në vitin 2015 krahasim me vitin 2014 janë realizuar të hyra më të ulëta diku 108,278 euro. Donacionet kanë qenë mbi 500,000 euro në vitin 2014, në 2015 janë 22,325 euro. E di që kryetari së bashku me stafin ka pasur angazhim të madh me takime në Prishtinë dhe jashtë vendit për të rritur donacionet, por ka ndodhur e kundërta. Kthyer në përqindje participimi dhe donacionet mbi 4% ka qenë në 2014, kurse 2015 janë 2,29 % kemi 100% rënie, kjo nuk është mirë aspak.

**Majlinda Ostroglava:** Lëvizja Vetëvendosje ka shqyrtuar me vëmendje pasqyrat financiare komunale për periudhën janar – dhjetor 2015. Ashtu siç e kemi thënë edhe më parë, se pasqyrat financiare janë matësi më i mirë i një qeverisje. Pavarësisht nga përpjekjet komunale, prapë rezultatet i keni kah luksi e jo nga interesat e qytetarëve, ku për dreka zyrtare janë shpenzuar 22.000€, mobilie 45.000€, shpenzime të udhëtimit zyrtar brenda vendit 17.000€. Do të ishte mirë ta kishim një shpjegim se çka kuptojmë me pajisje tjera, ku është një shumë e shpenzuar prej 124.000€, dhe furnizime për zyre 81.000€. Ne e dimë që problemet e qytetarëve të Vitisë janë të shumta dhe me këtë buxhet nuk mund ti zgjidhim, por me një vizion pak më të qartë mund të kryejmë punë edhe më shumë. Kjo periudhë nuk mund të kthehet, por një këshillë për qeverinë komunale që në këtë vit të punojnë më shumë për interesa të qytetarëve.

**Mirlinda Sadiku:** Më të vërtetë është shqetësuese rënia e investimeve kapitale për 282.000€, këtë shqetësim e kemi ngritur edhe vitin e kaluar, mirëpo nëse e shikojmë në mënyrë analitike, rezulton se 94.000€ që janë mbledhë më pak nga të hyrat komunale se në vitin 2014. Drejtoria e Kulturës e ka realizua planin vetëm 50%, e Urbanizmit 40%, Inspeksionit 47%, Shërbimet Publike 41%, Bujqësia sidomos rënie 30%. Ne dimë të gjithë se një pjesë e madhe e popullsisë merret me bujqësi, prandaj është një rënie goxho e madhe e cila duhet adresuar. Sa i përket shpenzimeve, duhet të ceket se kryetari ka bërë një shpenzim të madh të udhëtimit zyrtar jashtë vendit, dhe neve na intereson ta dimë çka ka përfituar komuna prej këtyre udhëtimit zyrtar jashtë vendit. Pastaj siç thotë z.Dauti komuna vazhdon të blejë shërbime kontraktuese të ndryshme, kjo është shifër prej 63.000€. Gjithmonë kemi menduar se ju do ti zbritni këto shërbime kontraktuese dhe kjo do të jetë në nivel më të ulët, por po rezulton diçka tjetër, prandaj është e rëndësishme që gjatë planifikimit të bëhet një planifikim real dhe të kihet parasysh se sa ka kapacitete një drejtori të inkasoj të hyra komunale, p.sh.: te Drejtoria e Inspeksionit e dimë se ndoshta ka mungesë të inspektorëve dhe se disa të drejta janë të deleguara nga qeveria, p.sh.: inspektorët për duhanpirësit, çdo herë kur të dilni në rrugë keni me gjet një vërejtje ku mundeni me bërë dënime për qytetarët nëse e thyejnë ligjin. Prandaj është shqetësues ky fakt që kanë rënë të hyrat vetanake dhe për këtë arsye duhet të bëhet një planifikim më i qartë dhe më objektiv, sepse kjo po rezulton me shifra negative.

**Bislim Bislimi:** Ne po vërejmë se vazhdimisht po shtohet numri i njerëzve që nuk po kanë mundësi ta paguajnë tatimin, kurse po rritet presioni i pushtetit për me inkasuar këto tatime. Këto politika vijnë si rrjedhojë e krizës ekonomike e që ne nuk po trajtojmë dhe nuk po dimë se ti qasemi asaj e të ju ndihmojmë atyre njerëzve që ata të bëjnë të mira materiale dhe me ato të mira materiale të kenë mundësi të ndajnë mjetet për tatime. Kështu që ne vazhdimisht

me këtë politikë si po shkojmë ne po shkojmë kah politika e totalitarizmit, ku pushteti ka ushtruar dhunë për me inkasuar tatim, ku ne do të detyrohemi ti rrisim tatimet për ndryshe nuk mund të ekzistojmë. Nëse nuk mund ta zgjidhim krizën ekonomike, atëherë shkaktohet kriza politike, nëse kriza politike nuk shkaktohet mund të shpërthej lufta. Prandaj i ftoj të gjithë ata që kanë kompetenca në kuadër të kompetencave të tyre në nivelin lokal, që të punojnë dhe ti ndihmojnë ata që nuk mund të paguajnë ose të ndihmohen ata që nuk kanë. Unë nuk po them për një 10% që kanë pare dhe nuk i dërgojnë edhe fëmijët në shkolla tona, nuk i mjekojnë fëmijët në ambulancat tona, nuk i shkollojnë fëmijët në shkollat tona, por i qojnë fëmijët në Amerikë si Hashim Thaqi, po e dërgon djalin përmes kolegjit privat në Amerikë për shkollim. Kam një pyetje, nafta është më e lirë: A ka ndikuar kjo në zvogëlimin e shpenzimeve për vetura të komunës, si dhe veturat të cilat janë blerë janë më ekonomike – harxhojnë më pak naftë.

**Ali Bajrami:** Pasqyrat financiare që jemi duke i diskutuar i kemi diskutuar edhe në raportin e punës së Kryetarit dhe drejtorëve të drejtorive që i kemi pasur. Kemi të prezantuara para vetës shpenzimet që janë bërë për vitin 2015, buxheti i alokuar dhe i shpenzuar. Kemi një shpenzim prej 98.90% të buxhetit, që ekonomistët po thonë se është shumë e mirë kjo përqindje e shpenzimit të buxhetit. Në të gjitha drejtoritë e kemi të shpenzuar buxhetin mbi 96-97%. Ajo çka më ra në sy te kodi 13508, pajisje trafiku, te shërbimet publike dhe inspekcioni, është mirë që në këto dy drejtori, që janë parapengues të shumë aksidenteve që në të shumtën e rasteve po janë me fatalitet në vendin tonë dhe për shenjzimin e rrugëve. Sa i përket të hyrave të drejtorive ato kanë qenë projeksione, diku kemi më pak të hyra të inkasuara se ato që janë të planifikuara, kurse në Shëndetësi dhe Gjeodezi kemi tejkalim të planit, kemi inkasim mbi 100%. Nuk duhet ti marrim këto si absolute, sepse diku kemi inkasuar më shumë se plani diku më pak dhe këto janë relative. Te Shëndetësia, furnizime mjekësore janë afër 30.000€, kjo është mirë se kemi një përkujdesje më të mirë shëndetësore. Shërbimet sociale janë afër 16.000€, kjo kategori e njerëzve ka nevojë permanente për ndihmë dhe duhet t'iu ndihmohet. Drejtoria e Rinisë ka 35.000€, sikur të ishin dyfishuar këto mjete kishte qenë më mirë, por mundësit buxhetore janë këto dhe e dimë sa janë të arriturat në këtë drejtori, por më së miri e pasqyrojnë edhe dy klubet që bëjnë gara në Ligën e parë të Kosovës. Te investimet kapitale 2.161.000€ janë mbi 35 projekte që janë realizuar e këto nuk janë pak, isha ndërlidhur me ato 7 mrekullitë e botës, por unë po i zbërthej në 7 të arriturat e Komunës së Vitisë që janë projekti i emergjencës, shkolla e mesme profesionale, pastrimi i shtratit të Lumit “Morava” dhe “Gerqarica”, që ka pas shumë herë vërshime, Qendra Mjekësore në Pozheran, parku i Pozheranit dhe të tjera.

**Daut Xhemajli:** Pasqyrat tregojnë një gjendje që ka ndodhë vitin e kaluar në të hyrat komunale dhe shpenzimet buxhetore. Unë nuk do të merrem me përqindje, por do ti shtroj do brenga dhe mendoj që qeveria duhet ti këtë parasysh. Natyrisht qeveria duke pas parasysh shpenzimin e buxhetit duhet të mendoj për planifikimin e buxhetit për vitin e ardhshëm, që planifikimi të jetë më i mirë. Është fjala për të hyrat buxhetore komunale, sepse në inkasimin e të hyrave komunale përgjegjësia është e drejtpërdrejtë e komunës. Sigurimi më i madh i të hyrave komunale është tatimi në pronë, mendoj se duhet me u pa seriozisht pse vazhdon me ra grumbullimi i këtij tatimi, pavarësisht se po thuhet se ka pas një arsye objektive që është miratuar Vendimi për faljen e borxheve, pavarësisht nga kjo duhet me u krye obligimet që i kanë për vitin kalendarik. Borxhi është falë deri në vitin 2008, por ne kemi pas obligim që të kërkojmë borxhin për vitet tjera. Mendoj se ne kemi disa mangësi te tatimi në pronë, çështja e shpërndarjes së faturave, sipas meje është gabim posta me i shpërndarë, është dashur komuna ta merr këtë obligim. Çështja e rianketimit, e cila ndikon drejtpërdrejtë në inkasim,



sepse 1/3 e obliguesve të tatimit në pronë brenda vitit duhet të rianketohen. Shumë herë është përmend planifikimi jo i mirë dhe si rezultat i planifikimit jo të mirë nuk mundet me qenë realizimi i mirë. Në shkollën e mesme të hyrat janë të planifikuara 25.000€ a janë të realizuara 6000€. Ose për shfrytëzimin e hapësirës publike parkimit etj. Hapësira publike në Viti është pa kontratë, arsyet pse është kështu nuk i di, rrugëve flitet gjithçka, por shpjegim zyrtar nuk ka pse është ndërprerë shfrytëzimi i kësaj hapësire. Është planifikuar shitja e masës drunore, por nuk kemi të hyra asnjë cent pse ka ndodhur kjo, dikush duhet të ketë shpjegim pse ka ndodhur kjo. Te Drejtoria e Arsimit janë harxhuar mjete në shumë prej 35.000€ për mobilje, unë mendoj se këtu nuk është fjala për mobilie, por për inventar duhet të shënohet inventar. Duhet me pas një përgjigje pse shpenzimet e rrymës në këtë vit janë mbi 30% më të mëdha dhe për pajisje tjera, duhet me ditur çka janë ato pajisje, sepse është një shumë prej 124.000€. Ne këto pasqyra nuk mundemi me i ndryshuar, por mundemi me e dhënë ndonjë vërejtje, sugjerim për me pas parasysh planifikimin për vitin tjetër apo shpenzimin e buxhetit për këtë vit.

**Bekim Azizi:** Pasqyra financiare është informatë se po të kishte me u votuar besoj se do ishin shumë më të kujdesshëm pozita, sepse është vështirë të kalohet. Në bazë të pasqyrës shihet se planifikimi i mjeteve dhe realizimi është jo i mirë, sepse në bazë të realizimit të të hyrave 77% tregon se 23% nuk janë realizuar të hyrat vetanake komunale. Unë mendoj se ose nuk keni mundur mirë me planifikuar ose nuk keni ditur. Unë mendoj që kjo e dyta është, sepse vërehet që ka një mosdije në këtë pushtet që nuk ka dije të mjaftueshme për të kryer punë taman. E kuptoj pse pozita fol mirë, sidomos te pasqyrat 22.437€ dreka zyrtare, nuk mundet me fol keq ai që hanë dreka zyrtare, ne tjerët flasim ndryshe, sepse nuk kemi qenë pjesë e këtyre drekave zyrtare që janë ngrënë. Te këto dreka qenkan 2.100€ te Drejtoria e Arsimit, mësimdhënësit nuk kanë pasur drekë në vitin e kaluar: Ku janë hëngër? Drejtori e din. 11.264€ janë te DKRS-ja, kjo është një shumë e madhe e mjeteve. Ne e dimë se disa janë për manifestimin e “Flakadanit të Karadakut”, por kjo është shumë e madhe. Ne nuk po e dimë a ka pas më shumë aktivitete apo dreka, këtë nuk po e dimë. Te të hyrat, të hyrat e tatimit në pronë janë shumë të vogla, nga inspektorati 96€, nuk dihet çka kanë bërë këta njerëz, a ju vjen keq që për një vit kanë mbledh 96€. Vetëm dy njerëz ti kishin dënuar duke pirë cigare nga 50 euro kjo shumë tejkalohet. Kjo shihet sa kanë punuar ose janë penguar për me punuar. Investimet kapitale 2.000.000€, këto mjete një firmë sot i shpenzon, mos mendoni se keni investuar shumë në investime kapitale. Vjollca tha ka ndryshuar Vitia, por me 2 milion nuk ndryshon një oborr e le Vitia, por me këto para janë kryer disa punë që i kanë parë qytetarët i keni mbledhur disa lule, janë shtruar disa asfalte ka 2-3 metra, asnjë metër ujë për dy vite. Problemi kryesor i qytetarëve të Vitisë është uji i pijes. Ju nuk keni rregulluar asnjë metër të ujësjellësit. Kjo është një prej dështimeve që duhet me iu ardhur turp në rrugë me dalur, patjetër me iu pyetur Zeka a ia keni bërë analizat atij uji që ka investuar vetë qytetari, të paktën atij me ia bërë. Investimet kapitale, në tremujorin e fundit janë shpenzuar 60% të mjeteve të parapara për investime kapitale, kurse për 9 muaj 40%, kjo nuk është në rregull, për këtë punët nuk kryhen mirë. Përcjellni punët që janë kryer ose asfaltet që janë prishur, sepse veç me asfalte nuk shkohet, kemi sa duash mundësi me fol për këtë raport, pasi nuk votohet mundemi me paraqitur vërejtje e sugjerime.

**Ibrahim Rama:** Unë pajtohen edhe me ju që bëni vërejtje, shumë natyrisht që edhe vërejtjet shnoshin edhe qeverisjen për me ec përpara, të japin edhe impulse, megjithatë ka edhe të mira edhe në këtë qeverisje, nuk duhet me i pa vetëm zi, sepse ka shumë punë që janë bërë të mira. Në Drejtorinë për Financa, unë i zbatoj politikat e Kryetarit të Komunës dhe buxhetin që e miratoni ju në Kuvend. Buxheti duhet me qenë i planifikuar mirë. Pasqyrat

financiare paraqesin ekzekutimin e buxhetit. Në asnjë kod të buxhetit për vitin 2015 nuk ka tejkalim. Po të kishte tejkalim pasojnë masat ligjore. Buxhetin të cilin ju e keni miratua ne kemi për detyrë me e shpenzuar. Nuk guxojmë me thënë kemi planifikua dreka zyrtare 23.000€, kurse i kemi harxhua 12.000€, edhe kjo është keqqeverisje. Ne duhet ta shpenzojmë buxhetin ashtu si është planifikuar. Shpenzimi i buxhetit për 98,90% nuk është i keqë. Te të hyrat vetanake, është bërë përpjekje që të hyrat vetanake të inkasohen. Deri në fund të vitit ne nuk kemi pas dijeni sa qytetarëve ju ka fal borxhi, për këtë ka një ulje të inkasimit të të hyrave nga tatimi në pronë. Tash para tri dite na ka ardh lista e spastruar e faljes së borxheve. Unë i kam marr të gjitha masat ligjore për inkasimin e tatimit në pronë. Të hyrat të cilat janë të inkasuara nga tatimi në pronë të gjitha janë përdor për investime kapitale. Nga 370.000€ që janë bërë nga tatimi në pronë ne kemi investu me të hyra vetanake për projekte investive 409.000€. Shpenzimi i buxhetit për investime kapitale, në vitin 2015 për investime kapitale nuk i kemi me buxhetin komunal të planifikuar 2183.000 si e kemi pas në vitin 2015, apo 2.350.000€ si e kemi pas në vitin 2014, e kemi me kornizë buxhetore vlerën prej 1.510.000€, apo afër 610.000€ për investime kapitale. Ju nuk parashtuat pyetje pse nuk është shpenzuar buxhetit 100%, apo ku janë mjetet që nuk janë shpenzua pre 1.10% të buxhetit dhe e shpjegoi këtë. Prej kësaj shume ne kemi suficit prej 60.000€, nga burimet vetanake këto mjete nuk humbet dhe mund të paguhen në vitin 2016. Vlera prej 15.282€ është suficit i humbur, këto mjete janë nga grandit qeveritar dhe janë kthye në nivel qendror.

**Bekim Azizi:** Unë ia kisha bërë një pyetje të shkurt drejtorit, 15.282€ janë humbur se ne nuk kemi dëshiruar që ta shkelim ligjin. Unë qe një vit jam duke kërkuar, se ju në vitin 2014 e keni shkel ligjin me 40.000€ të kanalizimit të fshatit Smirë dhe 70.000€ të kanalizimit të fshatit Terpezë. Unë jam duke e kërkuar këtë dokument qe një vit dhe nuk e keni dhënë. Sot po më vjen mirë që publikisht po thoni se nuk ke dëshiruar me e shkel ligjin dhe 15 282€ i keni kthye në ministri. Unë jam duke e kërkuar nga ju këtë dokument që në fund të dhjetorit ju e keni nënshkruar, që 40.000€ të kanalizimit të Smirës dhe 70.000€ të kanalizimit të Tërpezës keni paguar pagesa për projekte të ujësjellësit. Këtu po shihet se është shkel ligji. Unë këtë jam duke e kërkuar. Sot po më vjen mirë që e pranuat se nuk keni dëshirua ta shkelni ligjin dhe shumën prej 15.282€ e keni kthye në ministri.

**Samet Idrizi:** Unë në fillim e thash, se duhet me qenë fer dhe me kritikuar aty ku nuk është në rregull. z.Aliu u mundua me e arsyetuar shpenzimin e buxhetit për vitin 2015, por ka disa shpenzime të cilat janë bërë a nuk është dashur me u bërë. Është planifikuar të inkasohen mbi 1 milion të hyra vetanake, mirëpo janë inkasuar 781.607€ apo 100.000 më pak se vitin 2014. Drejtori u mundua me e arsyetua pse nuk është realizua planifikimi i të hyrave vetanake, ai po bën pak politikë, në pyetje të cilat po ia parashtrojmë ai nuk po përgjigjet. Nëse një komunë dëshiron me u zhvilluar zakonisht duhet me qenë në borxhe jo mos me mundur me i harxhuar parat. Nuk është sukses shpenzimi i buxhetit për 98.90%, është dashur dhe më shumë me u harxhuar buxheti. Edhe unë punoj në një institucion publik, edhe aty janë falur borxhet, janë bërë prerjet, por ne kemi vazhdua të punojmë dhe kemi inkasua të hyra për 100.000€ më shumë se planifikimi, kurse në komunë ka ndodh e kundërta, janë mbledhë 100.000€ më pak se në vitin 2014. Duhet të pranohet se ky është dështim. Drejtori fol me komoditet për të hyrat vetanake, por duhet me e pranuar se është dështim dhe nuk është punuar sa duhet. Te investimet kapitale nuk është punuar sa duhet, është dashur të ruhen investimet kapitale, jo prej 2 milionë euro me rënë 1 milionë e gjysmë. Te subvencionet në bujqësi, nuk janë shpenzuar 100%. Subvencione në bujqësi me i pas edhe 2.000.000 € ke ku me shpenzua e leje më këtë shumë prej 30.000€. Edhe një herë po të them z.Ali se diçka është investuar, por kur e krahason me planifikim dhe vitin paraparak është keq.

**Ali Bajrami:** Unë nuk dua të polemizoj, por këto që i kam thënë a qëndrojnë apo nuk qëndrojnë, dhe po dua që qytetari me u bindë se unë e kam thënë të vërtetën.

**Ibrahim Rama:** Unë do të jap përgjigje në këto dy pyetjet e fundit. Te kategoria ekonomike për subvencione, është më pak buxheti i shpenzuar, se me një vendim të kryeministrit janë nda 27.500€ për kompensimin e dëmeve. Me vendim të Kuvendit, këto mjete janë destinua për një qëllim tjetër, të caktuar për rregullimin e lumit "Morava". Ato mjete ende nuk janë kthye nga Qeveria në këtë fond, për at arsye del se buxheti për subvencione është shpenzuar rreth 70.%. Kurse te kultura kemi zbritje të buxhetit në shumë prej 16.000€, është fjala për fondin e "Kross Border", i cili nuk është shpenzua total më vitin 2015. Ka mbet një vlerë prej 16.500€ me u shpenzua në vitin 2016, për këtë arsye del në këto dy drejtori shpenzimi i buxhetit më pak. Sa i përket pyetjes së z.Bekimit, Ligji për Menaxhimin e Financave Publike përcakton të drejtat e kryetarit të komunës, ministrit, qeverisë dhe kuvendit të nivelit qendror çfarë të drejte kanë me i bart mjetet prej një projekti në projektin tjetër. Shumën e mjeteve që nuk janë krye punët në investimin e kanalizimit të fshatit Smirë prej 40.000€, janë paguar 12.400€ projektin e kanalizimit të fshatit Smirë dhe 27000€ është paguar pjesë të e punëve të realizuara në kanalizimin e fshatit Trestenik. Këto mjete nuk janë humbë. Kjo punë është bërë konformë të ligjit, që i jep të drejtën kryetarit të komunës me e bërë bartjen prej një kodi në kodin tjetër.

**Kryesuesi:** Pasi kjo pikë nuk votohet kalojmë ne pikën e tretë të rendit të ditës.

### **3. Propozim për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për LMK**

**Nënkryetari:** Ju e dini se në seancën e parafundit kemi miratuar Rregulloren për Leje Mjedisore. Përgatitjet për hartimin e kësaj rregullore janë bërë në muajin tetor, kurse rregullorja është aprovuar para vitit të ri, përkatësisht më 29 dhjetor. Rregullorja nga MAPL-ja është kthye që të rishqyrtohet dhe të harmonizohet me Udhëzimin e ri Administrativ nr.17/2015. Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e ka harmonizuar rregulloren dhe ia japim fjalën drejtorit të drejtorisë që ta paraqet fjalën hyrëse lidhur me këto ndryshime në propozim rregullore.

**Ajet Sallahu:** Qëllimi i ndryshimit dhe plotësimit të kësaj propozim rregullore është harmonizimi me Udhëzimin e ri Administrativ nr.17/2015 të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale. Ndryshimi është bërë në hyrje të rregullores, se rregullorja duhet bazuar në Udhëzim Administrativ nr.17/ 2015, i cili është aprovuar më 01.12.2015. Rregullorja e cila është propozim për ndryshimin dhe plotësimin është hartuar në muajin tetor të vitit 2015, dhe ndërkohë gjatë miratimit është nxjerr Udhëzimi i ri Administrativ për dhënien e lejes mjedisore komunale. Nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është kërkuar që të rishqyrtohet Rregullorja për Leje Mjedisore Komunale nr.01-013/1743, e datës 29.12.2015, dhe e njëjta të harmonizohet me Udhëzimin e ri Administrativ 17 /2015 për dhënien e lejeve mjedisore komunale. Ndryshimet në rregullore janë shumë të pakta, por është dashtë të ndryshohet dhe plotësohet me Udhëzimin e ri administrativ. Është ndryshuar te neni 2, pika 1.9, lidhur me kompetencat, lidhur me miratimin dhe refuzimin e dhënies së lejes mjedisore komunale. Neni 3 dhe 4 është kompetenca për zhvillimin e procedurës për lëshimin e LMK, ku është e caktuar Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit. Pastaj te neni 6, pika 1.7, në vend të Raporti i LMK duhet të përmbaj të dhënat personale emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e hartuesit dhe aplikuesit. Neni 7, është paraparë përpilimi i raportit për marrjen e LMK-së dhe Neni 9, janë paraparë tarifatat për tu pajisur me LMK. Apikuesi për tu pajisur me LMK duhet të paguaj 0.2% të vlerës investuese të projektit. Këto janë ato ndryshime të cilat janë bërë në rregulloren për Leje Mjedisore Komunale, e cila është aprovuar më 29.12.2015.

**Kryesuesi:** Hapim diskutimin për këtë propozim rregullorë: Kush donë ta merr fjalën?

**z.Sami Demelezi:** Kryesuesi dhe drejtori i sqaruan arsyet e propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e kësaj rregulloreje, dhe meqenëse këtë rregullorë e kemi miratuar në një nga mbledhjet që e tha edhe drejtori, në seancën e parafundit dhe duke pasur parasysh faktin se drejtori me stafin e tij kanë bërë harmonizimin e kësaj rregulloreje me udhëzimin administrativ të dalur nga ministria, kujtoj se ka pak vend për ndërhyrje në këtë rregullorë, prandaj unë dhe grupi ynë jemi pro kësaj rregulloreje.

**z.Samet Idrizi:** Grupi i PDK-së e përkrah këtë propozim për ndryshim dhe plotësim, e kam një pyetje për drejtorin, veç sa për sqarim. Neni 8, komisioni profesional në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të raportit duhet të jap mendimin me shkrim, i cili është parakusht për miratimin ose refuzimin e dhënies së lejes. Kam dëgjuar shpesh për procedura të gjata nëpër komuna, por edhe ministri: A ka mundësi me u shkurtuar në 20 ditë? Dhe neni 9, për tu pajisur me leje mjedisore komunale aplikuesi duhet të paguaj tarifën prej 0,2% të vlerës investuese të projektit: A duhet të jetë e ngjashme për të gjitha këto natyrat e punës që janë këtu te shtojca?, si p.sh.: kërkon leje mjedisore për një autolarje: A duhet me qenë njëjtë edhe për një profesion që është shumë më i avancuar?, vetëm sa për sqarim.

**Kryesuesi:** Meqë nuk ka diskutues tjerë, urdhëro drejtor.

**z.Ajet Sallahu:** Neni 8, është afati maksimal 30 ditë mund të jepet edhe në afat më të shkurtër, dhe e dyta të vlera 0,2 % të vlerës investuese është vlera për të gjitha veprimtaritë që kërkohet leje mjedisore komunale.

**Kryesuesi:** Pas diskutimit e hedhin në votim këtë pikë të rendit të ditës: Kush është që të miratohet kjo rregullorë? Konstatohet se me vota unanime u miratua kjo rregullorë.

Si pikë të katërt të rendit të ditës kemi

#### **4. Propozim vendim për shpalljen zonë me interes të përgjithshëm, parcelat në zonat kadastrale në Viti dhe Sodovinë të Jerlive, të cilat prona janë të menaxhuara nga AKP-ja**

Ja kisha dhanë fjalën përfaqësuesit të Drejtorisë së Kadastrit, rreth kësaj pike të rendit të ditës.

**z.Tajar Neziri:** Si të gjitha komunat edhe Komuna e Vitisë është në gjendje jo të mirë sa i përket pronave publike, duke u nisur nga kjo problematik shqetësuese dhe sfiduese, ne kemi marrur edhe veprimet e duhura, që konform dispozitave ligjore, ku disa nga parcelat të cilat janë me rëndësi për realizimin e interesit publik për çështjet e komunës dhe nevoja për ushtrimin e kompetencave brenda komunës në përgjithësi ti shpallim me interes publik. Mbështetur në ligjin për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme, komuna ka të drejtë që për interes publik apo të përgjithshëm të kërkojë kthimin e pronave të paluajtshme, që përfshijnë tokat e ish-ndërmarrjeve shoqërore, të cilat menaxhohen dhe administrohen nga AKP-ja. Bazuar në këtë, kryetari i komunës ka bërë kërkesë me datën 18.01.2016, drejtuar Presidentes së Kosovës, Zyrës së Kryeministrit, MAPL-së, kryetarit të komisionit parlamentar për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri, Bordit Menaxhues të AKP dhe Zyrës Regjionale të Agjencisë Komunale të Privatizimit në Gjilan. Para jush e keni materialin e përshkrimit të zonave kadastrale dhe numrin e parcelave. Kërkojmë nga ju që të miratoni këtë propozim vendim.

**Kryesuesi:** Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës.

**znj.Vjollca Halili:** Mendoj që ka qenë mirë me i pasur me kohë parcelat, me ditur se për cilat është fjala, përpos një njoftimi që keni bërë nuk i kemi saktësisht parcelat se për çka është fjala, domethënë zonat e caktuara dhe duke u bazuar në faktin që këto parcela janë të lidhura direkt me zhvillimin ekonomik të komunës, janë në interes publik dhe ndikojnë edhe

në mirëqenien e qytetarëve të Vitisë. Grupi i LDK-së së Vitisë është pro këtij propozim vendimi.

**z.Bekim Azizi:** Duke pasur parasysh që këto parcela kadastrale janë në interes të qytetarëve të Komunës së Vitisë, grupi i PDK-së përkrah plotësisht këtë projekt propozim.

**z.Sejdi Emiri:** Edhe ne mendojmë që vendimi është shumë i qëlluar, është zonë me frekuencë bukur të madhe, është vend që mundet me ndikuar shumë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të Vitisë, e përkrahim.

**Kryesuesi:** Si duket nuk ka më të interesuar për debatim, atëherë e hedhim në votim: Kush është që të miratohet ky propozim vendim? Konstatoj se me vota të të gjithë të pranishmëve miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

## **5. Informatë mbi procesin e legalizimit të objekteve**

**Kryesuesi:** I japim fjalën drejtorit të drejtorisë përkatëse rreth kësaj informate.

**z.Ajet Sallahu:** Procesi i legalizimit ka filluar më herët dhe ka qenë faza e paraqitjes së objekteve pa leje, dhe ne nuk kemi pasur ndonjë rezultat të mirë, sepse nga 10 mijë e diçka objekte sa konsiderohet se janë pa leje në Komunën e Vitisë janë paraqitur vetëm 3190, prandaj ajo fazë ka përfunduar me 5 shkurt 2015 dhe ka vazhduar në formë ankese deri më 11 qershor 2015 dhe numri nuk është rritur aq shumë, por është rritur vetëm në ditën e fundit kur ka përfunduar afati. Faza e dytë, faza e paraqitjes ose e aplikimit ka filluar me 16 shtator 2015 dhe përfundon me 15 mars 2016, do të thotë në këtë fazë parashihet që të aplikojnë të gjithë ata që i kanë paraqitur objektet pa leje dhe përkundër të gjitha përpjekjeve që i kemi bërë nuk është parë ndonjë sukses, dhe nga 354 mijë objekte të paraqitura pa leje kanë aplikuar vetëm 400, kurse në Viti nuk e kemi pasur asnjë. Nëse jeni të interesuar për më shumë jam në dispozicionin tuaj.

**z.Sejdi Emiri:** Kjo pikë, informatë mbi procesin e legalizimit të objekteve, është një problem bukur shqetësues në Komunën e Vitisë. Unë mendoj që nuk është problemi vetëm ti legalizojmë objektet që janë të ndërtruara pa leje, por të fillojmë ti ndalojmë objektet që ende po ndërtohen pa leje. Përderisa nuk i ndalim këto objekte që janë duke u ndërtruar pa leje, kot e kemi ti legalizojmë ato në të kaluarën që i kemi. Për ta bërë këtë gjë, unë mendoj që puna kryesore është që tua lirojmë taksat, sepse taksat janë të papërbalueshme për qytetarët që i kanë ndërtruar ato objekte dhe ta bëjmë një strategji, se përndryshe veç çka kemi mu thëlluar në këtë drejtim. Unë nuk po shoh ndonjë zgjidhje me këtë informatë që na ka ardhur, unë po pres që me dalur ju me një zgjidhje konkrete, me një alternativë, që qytetarët me të vërtetë me i realizuar këto objekte, se mundemi të flasim edhe dy vite qeverisje që i keni, ndoshta edhe 4 vite pastaj kush e merr dhe mos me u zgjidhur kurrë problemi, por ne po duam zgjidhje konkrete, e zgjidhja konkret mendoj është te pagesat dhe te taksat, nëse ua lirojmë taksat dhe pagesat, atëherë edhe ata kanë me u detyruar me legalizuar.

**z.Bekim Azizi:** Përderisa është informatë dhe në informatë shkruan, që deri më tani nuk është bërë asnjë aplikim, unë e kisha pyetur drejtorin: Pse bile ky nuk ka aplikuar me legalizuar shtëpinë e tij kur është drejtor i saj, mos është bajat që kjo kur drejtori nuk aplikon, kur kryetari nuk aplikon, kur nënkryetari nuk aplikon, kur kryesuesi nuk aplikon me legalizuar shtëpinë, çka ka me aplikuar qytetari? Unë nuk mundem të aplikoj pa aplikuar drejtori, këtu është problemi.

**z.Hasan Aliu:** Ato të cilat po i ngritin këshilltarët i kam ngritur edhe unë në një takim me amerikan dhe e kam parë se është problem, sepse nuk është fjala për legalizimin e objekteve pas vitit 1999, bëhet fjalë për legalizimin e të gjitha objekteve që janë në Kosovë dhe me kohë kam thënë që këtij procesi duhet ti gjendet zgjidhja, sepse me legalizuar një shtëpi duhet edhe

projekt dhe duhet inxhinier dhe asnjë inxhinier nuk merret me ndonjë shtëpi që ai nuk e ka projektuar. Në rast se nuk vendoset kadastër i ri, siç ka ndodhur pas luftërave të ndryshme dhe del e bën incizimin dhe e përshpejton procedurën dhe e dëshmon me dëshmitar se e kujt është parcela, atëherë lehtësohet kjo çështje.

**Kryesuesi:** Besoj se e shtjerrëm diskutimin rreth kësaj pike të rendit të ditës, dhe meqë nuk votohet, ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë.

Si pikë të fundit të rendit të ditës kemi paraparë

## **6. Informatë mbi përgatitjen dhe mirëmbajtjen e rrugëve në sezonin dimëror**

**Kryesuesi:** Ftoj drejtorinë e drejtorisë përkatëse ta merr fjalën.

**z.Nexhmedin Jakupi:** Shërbimet për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë zezonës dimërore, tenderin e ka “Zuka Commerce”, e cila edhe vitin e kaluar i ka mirëmbajtur. Ne qysh në fillim të muajit të 12 kemi kërkuar nga kompania që të siguroj mekanizmin e nevojshëm për pastrimin e rrugëve, si dhe të siguroj edhe kripë të mjaftueshme për rrugë. Më poshtë e keni edhe aktivitetin të cilin e ka zhvilluar drejtorja në koordinim me kompaninë gjatë ditëve të janarit, që kishte të reshura të mëdha të borës. Materialin e keni pranuar me kohë, e keni para vetes, për sqarime të mëtejshme jam në dispozicionin tuaj.

**z.Samet Idrizi:** Falënderojmë drejtorin për këtë informatë! Drejtori e përmirësoi, se në letër shkruan ka pasur reshje të borës pa ndërprerë në disa fshatra, por këtë vit ka pasur borë shumë pak, ne e dimë, por e përmirësoi informatën drejtori. Drejtor, e kam një pyetje, rruga “Dëshmorët e Kombit”, që shkon te varrezat e dëshmorëve, para ish-stacionit të veterinarisë është “Ylvi Demiri”, aty nuk është intervenuar me eskavator fare, por kemi pasur fatin nuk ka rënë borë shumë, unë jetoj në atë rrugë, nuk është intervenuar, nuk ka qenë shumë keq, por megjithatë nuk është intervenuar, e herave të tjera është mirë me u intervenuar edhe në atë rrugë, tash janë rrugët të gjitha të emëruara dhe nuk është vështirë me identifikuar ku është intervenuar dhe ku nuk është intervenuar, dhe puna e trotuareve, Beka ka pyetur seancën e kaluar, borën prej rruge po e qesin në trotuar, tash fëmijët e shkollave, por edhe qytetarët po detyrohen të ecin në rrugë, kështu që një vëmendje pak ma e madhe kësaj pune me i kushtuar në të ardhmen. Dashta me ta bërë edhe një pyetje: Si bëhet realizimi i kontratës, është pyetja për vlerën monetare?, por ti dhe sqarime, domethënë kontrata si total është 48 mijë, por nëse bie borë pak nuk paguhet krejt apo?

**z. Sejdi Emini:** Edhe pa na i sjellur informatat e kemi ditur gjendjen siç ka qenë, ka shumë fshatra që nuk ka shkuar fare bageri, është Ramjani dhe Novosella siç e di unë, a është e vërtetë, arsyeja që e ke dhënë është se nuk ka pasur mjete të mjaftueshme e nuk e di si mundemi me arsyetur ne kur nuk ndajmë mjete të mjaftueshme me i pastruar rrugët. Është fat i madh që nuk ka rënë shumë borë e nuk ka pasur të reshura, e gjejmë mjete për të paguar dreka dhe darka, kjo është në kundërshtim me atë që e thash në fillim, nëse ne nuk e planifikojmë atë që duhet ta planifikojmë, domethënë shërbimin e qytetarit, e planifikojmë të hamë dreka e darka tonat, atëherë është më mirë ta lëmë krejt e mos me ardhur këtu.

**Kryesuesi:** U parashtruan dy pyetje, urdhëro drejtor jep përgjigje.

**z.Nexhmedin Jakupi:** Ne gjatë zezonës së dimrit i pastrojmë vetëm rrugët kryesore nëpër lokalitete dhe Viti, buxheti është 48 mijë euro, unë ua prezantova një fakt se vetëm gjatë këtyre 3-4 ditëve kemi shpenzuar dikund afër 5000 euro. Nga niveli qendror vetëm 10 mijë euro na ndahen si komunë për mirëmbajtjen e këtyre rrugëve, ndërsa pjesën tjetër duhet ta ndajmë nga të hyrat vetanake.

**z.Sami Demelezi:** Unë po propozoj kështu, mos të hamë mëngjes, mos të hamë drekë dhe mos të hamë darkë e të blejmë dru me u ngrohur.

**Kryesuesi:** Ju falënderoj për kontributin që dhatë në këtë seancë, me kaq e shpall të mbyllur këtë seancë.

Mirë u pafshim!

**Mbledhja përfundoi me punë në ora 12 e 30 min.**

**Procesmbajtës :**  
**Ilir Zuka**

-----

**Kryesuesi i Kuvendit të komunës së Vitisë**  
**z.Naim Pira**

-----